



**Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE**

THIRRJE PËR OFERTË

Realizim të videove të shkurta vetëdijesuese

Programi për të drejtat e njeriut, "HUMAN RIGHTIVISM", i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida), ka për qëllim që nëpërmjet shoqërisë civile të përmirësoj të drejtat e njeriut, që janë të natyrshme, origjinale dhe të bazuara në interes të grupit, përmes këtyre tri komponentëve: 1) Të drejtat e njeriut dhe aktivizimi arsimor; 2) Dokumentimi; monitorimi (watchdog) dhe qasja strategjike dhe 3) Të drejtat mjedisore.

EC Ma Ndryshe është njëra nga organizatat përfituese të këtij programi, në kuadër të të cilit shpall këtë thirrje përmes së cilës fton kompanitë/konsorciumet e interesuara të dorëzojnë ofertat e tyre për **"Realizim të tre (3) të videove të shkurta vetëdijesuese"**.

Videot e realizuara duhet të pasqyrojnë gjendjen e degradimit dhe në të njejtën kohë të ngritjes së vetëdijes së qytetarëve për mbrojtje të ambientit/mjedisit, të lumenjëve/ujrave, të ajrit, të pyjeve në Kosovë.

Gjatë realizimit të videove duhet të merren parasysh që kohëzgjatje e videove duhet të jetë minimum 0.45 sec dhe maksimumi 1.30 minutë; videot duhet të jenë të realizuara në përputhje me specifikat për publikim në Facebook, IG TV, Instagram, Youtube dhe website; muzika apo audio e përdorur në video duhet të jetë më të drejta të siguruara; videot të jenë të realizuara në format jo më të vogël se Full HD.

Afati i realizimit të videove duhet të bëhet gjatë muajit Dhjetor 2020 deri me Shkurt 2021. Gjatë realizimit të videos kompania videon duhet do ta ndajë për komente/konsultim me stafin e EC-it deri sa të merren parasysh komentet/sygerimet e stafit të EC-it dhe të finalizohet.

Kriteret për ofertim:

Oferta duhet të përmbajë dokumentet në vijim:

- Çmimi duhet të përfshijë koston profesionale dhe ato të transportit;
- Çmimi duhet të ofrohet për copë/video
- Kompania/konsorciumet duhet të dorëzojnë çertifikatën e regjistrimit të biznesit; çertifikatën e numrit fiskal; çertifikatën e TVSH-së (kompanitë që janë deklaruese të TVSH-së),
- Kompania/konsorciumet duhet të kenë së paku tre (3) vjet përvojë pune në prodhimin e videove dhe dokumentarëve;
- Pala ofertuese (kompania/konsorciumet) duhet të caktojë një person për kontakt direkt dhe komunikim me EC Ma Ndryshe.

Ofertat duhet të dorëzohen fizikisht në zyrat e EC Ma Ndryshe, Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren ose në mënyrë elektronike në info@ecmandryshe.org deri më datë 02.12.2020, ora 15:00 me shënim: **“Realizim të videove të shkurta vetëdijesuese”**

Ofertat që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen.

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga kompanitë/konsorciumet, nëse këtë e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare. Vetëm konsulentët/grupet e konsulentëve fitues do të informohen/kontaktohen.